

KOPIJA

Ballina: Valdrin Mustafa
dhe Albina Rashica
Foto: Genc Fona
Hair&Makeup:
Kaci & Sellma

**Pse
shqiptarët
e kanë
një dërrasë
eksik**

**E shet gjakun
për ta shëruar
fëmijën**

**Si jetojnë
ata që i kanë
nga dy gra**

**Kush është
Jeta Canaj**

**Kryetari Nazmi Viqa
me anëtarë të
Kryesisë së UB-së
në Kosovë**

*Valdrin Mustafa
& Albina Rashica*

*në altar, dasmë madhështore
e me emocione të forta*

remos

DENTFIX

HELPER
GENÈVE

SHERWOOD
Beauty and More

MARITIM
Interior & Exterior

allure
PARFUMS

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj
FISH RESTAURANT

MOLLA

Shkenda Dybesa
Desserts & Pastries

banaderm

BREZOVICA
HOTEL

CIMA
CASA DI MONTAGNA

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
**Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.**

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

Gjëja më e rëndësishme
në jetë është të mësosh
se si të japësh dashuri
dhe ta lejosh atë të
hyjë. Dhe, këtë gjë
tashmë e kanë
mësuar perfekt
çifti Albina
Rashica dhe
Valdrin
Mustafa.

Valdrin Mustafa
& Albina Rashica
në altar, dasmë madhështore
e me emocione të forta



Në Ballinë

Kushdo që i sheh i uron për jetë të gjatë së bashku, pasi duket se kanë lindur për njëri-tjetrin. Ata janë dy në një, dy trupa e një shpirt. Çifti sapo i kanë thënë Po-në e madhe njëri-tjetrit, duke u martuar me një ceremoni madhështore, e cila shënon tashmë kujtimin më mbresëlënës të jetës së tyre.

Dasma e futbollistit të talentuar dhe të njohur Valdrin Mustafa dhe bukuroshes e vajzës inteligjente e punëtore, Albina Rashica, do të mbahet në mend gjatë për madhështinë e saj, momentet e bukura, atmosferën e zjarrtë dhe momentet me emocione të forta.

ÇIFTI RRËFEJNË NJOHJEN DHE DASHURINË E TYRE...

Albina e Valdrini duan ta ndërtojnë jetën e të ardhmen së bashku, ashtu siç është më së miri. Albina Rashica është nga qyteti i bukur i Vushtrrisë, ku e ka kaluar pjesën më të mrekullueshme të fëmijërisë. Albina jeton prej nëntë vitesh në Gjermani, ku vepron dhe punon në biznesin familjar në rrjetin e restauranteve "remos", "të njohura në shumë metropole të Gjermanisë dhe së shpejti edhe me lokacione të reja. Rrjeti i restoranteve "remos", i familjes Rashica, është adresa e shumë njerëzve që duan të ushqehen shkëlqyeshëm dhe të relaksohen me një ambient unikat dhe një sistem shumë i suksesshëm.

Jeta e Albinës lidhet me

punën në këtë biznes të suksesshëm familjar, ku edhe e njohu njeriun e zemrës.

"Takimi ynë i parë me Valdrinin ka qenë një rastësi. Dhe, hera e parë që unë dhe Valdrini jemi takuar ka qenë në njërin nga lokacionet ku unë punoja. Aty nisi gjithçka për ne të dy.

Takimet me njeri-tjetrin filluan gjatë muajve të parë të vitit 2021", kujton Albina.

Siç kuptojmë, më 30 maj 2021 ishte dita kur për çiftin nisi një kapitull i ri, pasi ishte data kur të dy familjet u mbledhën për të festuar fejesën e Albinës dhe Valdrinit.

"Valdrini për mua është me shumë sesa një bashkëshort, është shoku i jetës sime. Jam shumë krenare për arritjet dhe sukseset në karrierën e tij si futbollist. Jam e lumtur që ai është pjesë e jetës sime dhe unë pjesë e jetës së tij", thotë me gojën plotë Albina, duke shtuar se data 16 gusht 2022 ishte dita që ata vulosën dashurinë përjetësisht, duke i premtuar njëri-tjetrit respektin, dashurinë, besimin, e kjo është data e martesës dhe ceremonisë që ende është një përjetim dhe emocion kaq i freskët për çiftin.

Nusja thotë se ky është nga vendimet më të mira që ka marrë në jetë. Njëjtë mendon edhe dhëndri, futbollisti Valdrin Mustafa, që është nga qyteti i Podujevës, por i lindur dhe i rritur në Gjermani.

Valdrini, njëjtë si Albina, është tejet i lumtur me gjendjen dhe, natyrisht, i dashuruar kokë e këmbë.

“Takimi im i parë me Albinën, që tanimë është shoqja ime e jetës, ka ndodhur në një nga restaurantet e “remos”, ku unë jam nën menaxhimin e pronarit Remo Rashica si futbollist. Ndërkaq, data 30 maj 2021 ishte një nga ditët më të bukura si për mua ashtu edhe për Albinën, pasi atë ditë u bë fejesa jonë, duke pasur afër familjet tona, që kanë qenë dhe janë mbështetja jonë kryesore për çdo gjë”. Valdrini shprehet se Albina është bekimi më i madh për të, personi më i rëndësishëm në jetë. “Jam me fat që e kam afër vetes, është mbështetja ime më e madhe në jetë dhe në karrierë”, thotë ai. Albina nuk është nga ato femra që kanë dëshirë të flasin veç për vete, andaj shumë shpesh bisedën e orienton kah njeriu i jetës së saj, Valdrini. Flet për pasionin e madh të tij për futbollin, duke treguar se futbollin, fusha, topi, janë pjesë e pandarë e jetës së tij, është një pasion që nuk i shteret asnjëherë. Vetë Valdrini thotë se ëndrra e tij që në fëmijëri ishte të bëhej futbollist, ndërkohë që karrierën profesionale e ka nisur në moshën 16-vjeçare, në klubin e mirënjohur 1FC Kaiserslautern. “Vitet e mia më të mira në fushën e fut-

bollit kanë qenë në vitin 2016-2017, kur unë fillova të luaja për Shqipërinë në nivelin ndërkombëtar të të rinjve, pjesë e ekipeve U19, U20 dhe U21.

Më 7 gusht 2019 njoftova Federatën e Futbollit të Kosovës se kisha vendosur ta përfaqësoja vendin tim, Kosovën.

Më 2 shtator 2019 morra një thirrje nga Kosova U21 për ndeshjen kualifikuese të Kampionatit Evropian U-21 2021 kundër Anglisë U21 dhe bëra debutimin tim.

Për mua është privilegj i madh që unë të luaj për shtetin tim, Kosovën”, thotë ai. Ndërkohë, Valdrini ka filluar karrierën në 1 FC Kaiserslautern-Hannover 96 - SV Verl dhe tani është nën Kontrast me Klubin Elversberg, ku e kanë eliminuar gjigantin gjerman Bayer Leverkusen nga kupa e Gjermanisë.

Valdrin Mustafa, tashmë i plotësuar edhe në aspektin e ndjenjave, përkrahë me bashkëshorten e tij, Albinën.

Jeta është gjithmonë shumë më e bukur, më e lehtë dhe më kuptimplote, kur njeriu ka në krahë njeriun që do.

Kur bashkohen dy shpirta të dashuruar, çdo shfaqje, film, përrallë e histori reale mbyllet me “Happy End”.

Urime!

Nderim Neziri





Pamje te Shkolla "Elena Gjika" në Prishtinë

Pse shqiptarët e kanë një dërrasë eksik?!

Çdo ditë kafenë e mëngjesit e pi me shokë të Redaksisë përballë Shkollës fillore "Elena Gjika" në Prishtinë. Bisedojmë për mbarëvajtjen e punëve në Redaksi, për detyrat e reja, për përditshmërinë tonë, e të tjera të ngjashme... Por, arsyeja e këtij shkrimi është se në këtë pjesë të qytetit ka një frekuentim të madh të veturave, të cilat më shumë fishkëllojnë sesa që ecin, ngase gjithsecili dëshiron të kalojë sa më shpejt, kurse pengesa ka shumë, meqë, veç rrugës së ngushtë, nxënës dhe njerëz ka me bollëk... Por, sirenat e veturave nuk janë asgjë

karshi atyre që me xhamin e veturës hapur dëgjojnë këngë rep, herë-herë edhe këngë folklorike me zë shumë të lartë, siç thuhet, në kupë të qiellit. E, ata as që brengosen nëse ti je duke biseduar me tjetrin, nëse je duke bërë muhabet dhe të pengon, meqë në ato çaste as që mund të komunikosh nga zëri i lartë që vije nga muzika në veturat që ndalen shkaku i ngarkesës së madhe, si në pikën kufitare në Vërmicë, në kufirin Kosovë-Shqipëri. E, edhe më keq është kur në çdo çast kalon ndonjë me motoçikletë dhe i jep gaz të madh, e që shkakton

zhurmë aq të madhe sa detyrohesh t'i mbyllësh veshët... Dhe, të enjten në mëngjes, teksa kalon një i tillë, deshe a nuk deshe të rrëqethet trupi nga zhurma e madhe e motoçikletës... E, si pa dashje më dalin fjalët: Shqiptarët nuk i kanë të gjitha dërrasat, sepse shumicës u mungon nga një dërrasë! Dhe, mu ky mendim më lindi edhe idenë për këtë shkrim, për këtë frymëzim jo të mirë, për këtë frymëzim të pafat.

Isa ILAZI

JETON SIKUR NUK DO TË VDESE KURRË...



...dielli është i madh dhe ndriçues, por prapë e lë gjysmën e botës në terr. Kjo do thotë, sado e madhe të jetë mirësia në këtë botë, largësia do të ekzistojë. Çfarë më habit?

Njeriu!

Është i shqetësuar për të tashmen.

Pse?

Ai nuk jeton dot as sot, as nesër.

Ai jeton sikur nuk do të vdesë kurrë dhe vdes pa jetuar kurrë si duhet.

Eh, vjen një ditë dhe gjithçkaje i vjen fundi...

Prandaj, mos e merr jetën aq seriozisht. Askush nuk ka dalë i gjallë prej saj, prej jetës.

E ne, që e shajmë jetën, nuk e kuptojmë se e shajmë veten tonë, sepse jemi

ata që e bëjmë jetën të tillë.

*

Një plak, para se të vdiste, i afroi djemtë dhe u tha nga përvoja e vet: Në jetë njeriu duhet t'i mbajë me vete gjithmonë tri gjëra:

Një metër, një guri dhe një gjilpërë.

E pse këto? – e pyetën djemtë. – Pse ta mbajë metrin me vete?

Plaku u përgjigj: Ta mat vendin ku do të ulet në mesin e të tjerëve.

E, gurin pse?

Ta peshojë fjalën e vet para se të flasë.

Po gjilpërën?

Ta thumbojë veten para se t'i thumbojë të tjerët... – u gjegj plakui.

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

E shet gjakun për ta shëruar fëmijën!

250 gramë gjak për 200 euro. Kjo është matematika tragjike e Kosovës sociale, një dëshmi nëpër të cilën ka kaluar dhe po kalon shteti i Kosovës. Sepse, ky shkrim, i realizuar në vitin 2008 dhe i përjetuar edhe në vitet e mëpastajme, e edhe deri në ditët e sotme, është dëshmi si jetohe në Kosovë...

Kosova ka kaluar dhe kalon në stori të më të tmerrshme të sigurisë ekzistenciale. Me papunësinë më të madhe në Evropë dhe me rrezikshmëri të madhe sigurie, shtresa qytetare, e cila nuk ka mbështetje financiare, është detyruar

të sigurojë ekzistencë edhe nga shitja e gjakut personal!

Revista jonë, "Kosovarja", ka siguruar tri storje të prekshme jetësh, për të cilat flasin autorët.

Që të gjithë mendojnë se koha e

humanitetit i përket së kaluarës. Ishte koha kur bukën në Kosovë e siguronte Shoqata "Nëna Terezë".

E, tani, që është shteti, siguria sociale është edhe më në rrezik.

Shet gjakun për të shëruar vajzën!

Njëra ndër nënat, e cila e ka shitur edhe gjakun e vet për të siguruar jetën e vajzës, është R. K., e lindur në Gjakovë.

Ajo ishte grua e trafikuar për tri vjet radhazi dhe sot ka një vajzë me të cilën jeton në një shtëpi, të cilën e ka siguruar "Habitati", por duke paguar qiranë.

Ajo përkujdeset për babanë 75, vjeç, i cili, aktualisht, ndodhet në spital dhe me nënën 68 vjeçe, e cila është e verbër.

Nëna e një vajze, R. K., solli në Redaksi storiet e jetës së vet me fëmijën në dorë, duke e bartur nëpër mjekë. Ajo, duke përshkruar jetën e vet, thotë:

"Jam R. K., nga Gjakova, e lindur më 1980. Kam rënë në duart e trafikantëve menjëherë pas lufte, kohë për të cilën nuk dua të flas, sepse shënimet i kam deponuar në polici. Dua të shpaloj një detaj për ekzistencën time familjare. Nga koha e trafikimit kam një vajzë, së cilës me shumë vështirësi ia siguroj ekzistencën, krahas dy prindërve të sëmurë që i kam në përkujdesje.

Dhe, për të shpëtuar nga ai trafikim i tmerrshëm, më ka ndihmuar policia e Pejës. Isha shtatzënë kur më shpëtuan dhe më morën e më dërguan në Pejë, në QMG, ku mora ndihmën e duhur pas keqtrajtimit.

Si pasojë e rrahjes dhe maltretimeve jam detyruar të përdori edhe alkool, për çka pata komplikime me shtatzëni. I falënderoj shumë mjekët: dr. Samirin dhe dr. Burimin, që u përkujdesën për mua, si një grua e pambrojtur familjarisht.

Nga strehimorja u ktheva në shtëpinë e babait, në të cilën jetonim të tre, në një dhomë, me nëntë metra katrore. Babai pinte shumë duhan dhe vajza ime mori bronkit. Ajo u sëmurë dhe më shumë qëndroi në spital sesa në shtëpi.

I merrja 50 euro ndihmë për vajzën, por ajo ishte e pamjaftueshme. Në një rast shkova t'i jepja ndihmë mjekësore vajzës dhe, duke prituri në rend, dy vetë po flisnin për një të afërm të vetin në spital. Thoshin se do ta paguanin dikë nëse jepte gjak për të...

Unë, duke pasur shumë nevojë për para, me qëllim të shërimit të vajzës, e mora vajzën në krah dhe nga frika

se po më ikin ata që kërkonin gjak, u dola para dhe u thashë:

"Më falni, nga jeni?"

"Jemi nga Malisheva", më tha njëri prej tyre.

"Nëse keni nevojë për gjak për të afërmin tuaj, unë jam e gatshme ta bëj një gjë të tillë", u thashë.

Më shikuan me habi të dy, duke tundur kokën në shenjë pranimi se kanë nevojë për gjak.

U tregova se vajzën e kam të sëmurë, se nuk ka baba, se më duhet ta shëroja...

"Po", më thanë.

Bëmë marrëveshje dhe shkua me Transfuzionin e Gjakut. U paraqita si vullnetare për të dhënë gjak për personin e caktuar. I dhashë 250 gramë gjak për 200 euro.

Unë e di se jam anemike dhe nga ajo ditë më nuk jam mirë...

I kam njoftuar të gjitha institucionet për gjendjen e rëndë ekonomike që kam, por deri më tani askush nuk më ka dalë në ndihmë. Kërkoj ndihmë për fëmijën tim të pastrehë", thotë ajo, duke qenë mirënjohëse për çdokënd që e ndihmon.

E SIGURON BUKËN ME PORRETIN E TË BIRIT NË DORË!

Gati çdo ditë në lagjen "Qyteza Pejton" në Prishtinë, ata që pinë kafënë e mëngjesit në ndonjë lokal të kësaj lagjeje, shohin një grua të veshur me të zeza dhe me shami të bardhë në kokë.

Gruaja që thotë se është nga rrethi i Ferizajt, mban në dorë një portret djali të bukur, për të cilin thotë se ishte i biri i saj, i vrarë në luftë...

Kush e di të vërtetën?!

Kështu thotë ajo, rreth të gjashtëdhjetave, e cila lë përshtypjen e një gruaje bujare dhe korrekte.

E, ky është vetëm këndi vlerësues që sjell syri...

E vërteta mund të jetë edhe ndryshe nga që thotë ajo, por ne nuk paragjykojmë të marrim apo të mos marrim mëkatë...

Derisa pimë kafe, ajo ofrohet pranë nesh. I bëjmë një foto në telefon dhe e pyesim:

"Nga je? Kush është në fotografi?"

"Është djali im", përgjigjet ajo dhe

vazhdon: "Më është vrarë në luftë".

Dhe, posa i thotë këto fjalë, këtu mbaron çdo bisedë tjetër...

E, ta verifikosh një të vrarë në luftë, nëna e të cilit ekspozon foton e tij nëpër Prishtinë, nuk është e lehtë e as e drejtë. Këtë të drejtë e ka shteti dhe organet e drejtësisë, në mënyrë që përgjegjësia të adresohet nëse ajo grua gënjen apo jo...

Me shokët e komentojmë, pastaj, se si është e mundur që një nënë, që e ka humbur djalin në luftë, të kërkojë lëmoshë nëpër Prishtinë, duke u thirrur në portretin e të birit?!

Si është vrarë djali, në rrugë apo në luftë? Është dëshmor apo i vrarë në qerim hesapësh, apo e ka marrë foton nga interneti dhe këtë e bën për qëllime përfitimi?!

Në fakt, nuk e dimë kush është ajo, sepse fjalët që i shqipton më shumë janë me theks shkodran...

Sidoqoftë, njerëzit i fusin duart në xhepa dhe i hedhin para në dorë, me mëshirën se ajo është nëna e djalit të vrarë në luftë...

E, ajo që është për të besuar është pesha e problemit, sepse është vështirë të dilet për të kërkuar lëmoshë në publik...

Por, ajo, me pamjen e një gruaje pedante, me çarçaf të zi e shami të bardhë, me pamje brilante për moshën e saj dhe me fjalor akademik, nuk ndjehet aspak keq që kërkon lëmoshë, nga tavolina në tavolinë.

LYPËSI ME PROTEZË TË HEKURT

Në sheshin e Prishtinës, një djalë i ri me një protezë të hekurt në këmbë, ulur në trotuar, ka vënë një kuti kartuçi para vetes.

Thotë se e ka humbur këmbën në luftë. Dhe, s'ka pse të mos i besoj njeriu... Nuk e ka këmbën dhe nuk është i aftë për të siguruar ekzistencën.

E, a merret dikush me të?

As këtë nuk e dimë...

Ai thotë se me paratë që ia jep shteti nuk i siguron as barërat.

Dhe, storiet e lypsarëve në Prishtinë janë marramendëse. Sepse, derisa pimë kafënë e mëngjesit afër ëmbëltores "Fellini", të paktën pesë lypës zgjatën dorën për lëmoshë...

S. Muturi

Pse për të qenë e suksesshme duhet të jesh nga Peja?

Të afirmuarat kosovare: Rita Ora, Dua Lipa, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Lorianana Kuka, të gjitha me origjinë nga Peja...

Pse? Intere-sante, a?!

Rita Ora, Dua Lipa, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Lorianana Kuka kanë të përbashkët se të gjitha janë të suksesshme në rrafshin global, por edhe se janë me origjinë nga Peja dhe secila e ka emrin më të bukur e më shqip se tjetra. Me frymëzim e edukim familjar, kulturë urbane të shoqëruar me shumë punë, ambicie, e mbi të gjitha lirinë kolektive që kanë femrat pejane nga familja e rrethi, janë arsyet për sukseset e tyre. Dhe, mu kjo liri ka ndikuar që edhe në botën e bukurisë pejanet dallohen, si në garat për mis apo ato të modelimit...



Majlinda Kelmendi



Distria Krasniqi



Rita Ora



Dua Lipa



**MAGJISTRALJA PRISHTINË - FERIZAJ,
KONJUH 14000 LIPJAN**

+383 49 566 667 / WWW.DINO-COMPANY.COM

 DINO QERAMIKA



Kryetari i UB, Nazmi Viqa me anëtarët e kryesisë vizituan dy kompani të suksesshme në Kosovë

Kryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane, z. Nazmi Viqa, së bashku me anëtarët e Kryesisë, z. Bekim Bytyqi, z. Nexhmedin Veliqi, Vllaznim Kelmendi, si dhe disa afarist nga Diaspora, vizituan sot Fabrikën për prodhimin e dyerve dhe dritareve kundër zjarrit nga alumini RITEK dhe simotren e saj kompaninë Projektuese DETI JON ne Milloshevë me pronar z. Bali Baliu dhe bashkëpunëtore të tjerë.

Fabrika e dyerve dhe dritareve kundër zjarrit të gjithë prodhimin e saj e plasojnë në tregun Gjerman përmes Kompanisë së suksesshme simotër FATI, e cila është anëtare e Unionit në Gjermani.

Z. Viqa dhe anëtarët tjerë të Kryesisë së Unionit shprehen urimet dhe dëshirat e tyre që shembullin e z. Bali Baliu ta ndjekin edhe kompanitë tjera nga Kosova.





UNIONI I BIZNESEVE Shqiptaro-Gjermane me Drejtor Ekzekutiv Operativ (CEO)

Kryetari i UNIONIT të Bizneseve, z. Nazmi Viqa, prezantoi sot Drejtorin ekzekutiv të Unionit z. Fadil R. Abdullahu



Ekonomisti, Fadil R. Abdullahu ka marrë miratimin unanimit të anëtarëve të kryesisë së Unionit që t'i udhëheqë proceset operative të shoqatës në qendër dhe në degët e saja.

Z. Nazmi Viqa, në emrin e tij personal, kryesisë dhe të të gjithë anëtarëve të Unionit, i uroj mirëseardhje z. Abdullahu, duke i uruar shumë suksese në punë.

Kush janë milioneret e estradës?

GJYSTE VULAJ

Gjyste Vulaj njihet si këngëtarja milionere në estradën shqiptare. Vila, hotele dhe prona të tjera private janë vetëm disa nga pasuritë e saj. Nga të ardhurat e majme që merr nga muzika dhe bizneset që i posedon me bashkëshortin, Sokolin, i jepet mundësia për të bërë jetë luksi.

Gjystja është pasionante e madhe e shëtitjeve nëpër vende të ndryshme të botës, por ajo pasion tjetër duket t'i ketë edhe veturat e shtrenjta.

Por, me gjithë pasurinë që ka dhe jetën luksoze që bën, Gjystja vazhdon të punojë shumë. Këngëtarja shqiptare nga Mali i Zi është mjaft e angazhuar në dasma e ahengje familjare, ndërsa mbrëmjet i ka të rezervuara në Ulqin.



ARBNORA ADEMAJ

Dikur prezantuese e emisionit të sportit "Koha shitesë", si dhe ish – "Mis Kosova", tash shumë e angazhuar në Turqi me xhirime filmash, aktore shumë e veçantë, por edhe me bukuri të rrallë, ka arritur të bëjë edhe jetë luksi dhe të ketë pasur të madhe.

E ka mbuluar pluhuri i harresës...



Si u bë terrorizimi i pacientëve shqiptarë në Spitalin e Prishtinës?

Ky shkrim ekskluziv është botuar më 15 tetor të vitit 2002, në Revistë tonë, “Kosovarja”, në kuadër të të cilit flasin disa pacientë shqiptarë për sjelljet e paramilitarëve, policëve dhe ushtarëve serbë, përfshirë edhe stafin e doktorëve dhe të infermierisë serbe në raport me pacientët e shtrirë shqiptarë në Spitalin e Prishtinës gjatë kohë së luftës, më 1999.

Po e ribotojmë, meqë ditëve të fundit u fol shumë se si janë keqtrajtuar e maltretuar pacientët shqiptarë në klinikat e Spitalit të Prishtinës...

Njëri ndër pacientët e shtrirë në Klinikën Kirurgjike-Ortopedike gjatë luftës së vitit 1999, Qazim Gashi, flet për gjendjen e rëndë të pacientëve shqiptarë në këto dy reparte dhe për keqtrajtimet e tyre.

Qazim Gashi dëshmon si janë marrë në pyetje pacientët shqiptarë në sallat e operacioneve, si qepeshin pa anestezi fëmijët, si amputoheshin gjymtyrët pa nevojë, si ndërhynin policët në punët e mjekëve për t'i keqtrajtuar pacientët shqiptarë etj.

Dhe, duke rikujtuar Klinikën Kirurgjike-Ortopedike në Prishtinë, që nga 18 marsi e deri në prag të nënshkrimit të marrëveshjes së Kumanovës, Qazim Gashi (1981), nga fshati Zllash

i Prishtinës, shikon shpesh këmbën e djathtë, të goditur nga plumbi, për t'u bindur nëse është sot në jetë i gjallë, aty tek fliste pranë nënës që strukej pas shporetit, në lagjen e “Berishëve”, në periferi të Prishtinës.

Me emocione të thella Qazimi e kujton natën e operacionit, më datën 24 mars të vitit 1999, në mbrëmjen kur NATO-ja nisi bombardimet mbi caqet serbe në Kosovë e më gjerë.

Atë e kanë operuar dy mjekë shqiptarë më në zë në Klinikën e Kirurgjisë dhe Ortopedisë në Prishtinë, të cilët po atë natë u përshëndetën me pacientët shqiptarë, të mbetur aty për të shpëtuar jetën dhe shpirtin, meqë repartet e spitaleve mbusheshin me

çetnikë, paramilitarë, ushtarë e policë serbë, e me më së paku mjekë.

“Ka qenë tepër prekëse largimi i dy mjekëve shqiptarë nga spitali”, pohon Qazim Gashi, e që në atë kohë ishte vetëm 18 vjeç.

Mjekët shqiptarë thanë: “Zoti qoftë me ju, sepse më tej ne nuk kemi vend këtu!”, shton Qazimi, duke treguar ngjarjet e rënda me pacientët shqiptarë në spitalet e Prishtinës.

“Ne këtu nuk kemi më vend, sepse ky më nuk është spital e as që i përngjan klinikës. Ky është vend që po mbushet me uniforma dhe çetnikë!”, thanë dhe shkuan.

Dhe, pacientët mbetën në duart e serbëve dhe çetnikëve, më së paku të

E ka mbuluar pluhuri i harresës...

mjekëve...

Aplikimi i terapive varej nga infermieret serbe, të cilat kënaqeshin me plagët e pacientëve shqiptarë dhe me vdekjen e tyre, si dhe me torturimin e të gjithëve që ndodheshin në prag të vdekjes.

Nga plagët e marra në këmbë nuk kishte mundësi shërimi në ordinancat private që edhe ashtu po mbylleshin, për shkak të pranisë së madhe të çetnikëve serbë dhe rruga e vetme ku kërkohet kurim e shpëtim mbetet spitalet e Prishtinës.

Ka pasur shumë të plagosur shqiptarë, e që si pacientë u gjetën aty nga të gjitha anët e Kosovës, të mbetur nën mëshirën dhe fatin e kohës, ka sqaruar ai.

TORTURIMI I PACIENTËVE SHQIPTARË NË KLINIKËN KIRURGJIKE-ORTOPEDIKE NË PRISHTINË

Djaloshi që ka qëndruar në Klinikën Kirurgjike-Ortopedike në Prishtinë, gjatë luftës më 1999, Qazim Gashi, duke përshkruar gjendjen reale dhe ngjarjet e tmerrshme në këtë spital, thotë:

"Kemi pasur torturime fizike dhe psikike në vazhdimësi, por disa raste ishin shumë të rënda.

E sollën një ushtar të plagosur serb në repartin e këtij spitali, shoqëruar nga vëllai i tij, Miço. Ai, Miço, na ka maltretuar shumë.

Secilin pacient shqiptar që e takonte, e shqelmonte dhe i binte grusht. Ai futej në dhomat e pacientëve shqiptarë dhe i rrihte, madje edhe pacientët në gjendje të rëndë që ishin, para vdekjes...

Ngado që sillej, sulmonte dhe thoshte: "Pse keni hyrë në luftë me Serbinë? Pse ma keni plagosur vëllanë?"

Me ne ishte edhe një pacient nga fshati Bërnica, Zorani, 45 vjeç, i cili e motivonte ushtarin serb të na rrihte edhe më shumë...

Mjekët serbë dhe stafi i infermierëve kënaqeshin me sjelljen e tij prej kauboji nëpër reparte, teksa i rrihte pacientët shqiptarë...

Asnjë mjek serb nuk merrej me pacientët shqiptarë. Doktoresha Zorica çdo natë sillte nga një polic të uniformuar, e që futej në dhomat e pacientëve shqiptarë dhe i rrihte. Na akuzonin se ishim pjesëtarë të UÇK-së! E, akuza që na bëhej neve i kurajonte mjekët dhe infermieret serbe që të përdornin forcën shtaz-arake mbi ne, edhe pse ishim aty të shtrirë.

Ishte tepër rrëqethëse sa larg shkoi dhuna serbe në këtë spital ndaj shqiptarëve të shtrirë. Madje, edhe pacientët serbë, e që kishin paksa fuqi të ngriheshin në këmbë, na rrihnin neve, pacientëve shqiptarë! Në këtë mënyrë, shërimi në këtë spital, jo që u bë i pamundur për shqiptarët, por më shumë kërcënoshim për vdekje, sesa nga vetë sëmundja që kishim...

Më kujtohet si sot kur ia thyen kërdhokullën Selim Kerollit nga Skënderaj, akoma pa e shtrirë në repart si të plagosur.

Të gjithë ata që ndodheshin aty, iu vërsulën, duke e qëlluar me shqelma në plagë, derisa ia thyen kërdhokullën.

Selim Kerollit ia hapën plagën edhe më shumë, në vend se ta shëronin... Nuk di tutje çka ka ndodhu me të, sepse e kam lënë në spital në gjendje shumë të rëndë. Ka qenë e pamundur që çdo natë të mos dëgjohej britma e tij në dhomën e spitalit...

Atë e kanë rrahur çdo natë policët serbë në dhomën ku ishte i shtrirë, tregon Qazimi.

SALLA E OPERACIONEVE - ZYRË PËR MARRJEN NË PYETJE TË PACIENTËVE SHQIPTARË!

"Rast tmerrësisht i rëndë ka qenë momenti kur e sollën një ushtar me emblemën e UÇK-së në spital. I plagosur në dorë dhe këmbë të majtë. Ushtari me emblemë të UÇK-së në krahë, kishte një orë "Seiko". E rrahën me shqelma në fytyrë, me grushte dhe gjësende të forta. Unë shkova ta shihja, sepse isha vetë ushtar, por në rroba civile dhe me librezë të tjetër kujt.

Erdhën dy policë dhe më nxorën nga dhoma, ndërsa atë nisën ta rrihnin. Dëgjohej britma e tij, sepse ai edhe ashtu kishte dhimbje nga thyerja e kërdhokullës dhe plagës.

E kanë rrahur derisa u lodhën, pastaj e kanë nxjerrë nga dhoma. Kam dalë nga dera e dhomës sime për të parë se ku po e çonin. Nuk i shihej fytyra nga gjaku që i rridhte...

Këtë skenë e ka parë edhe një rom me emrin Hazir, me banim në Prishtinë, i cili shtëpinë e kishte mbi hekurudhë, te vendi i quajtur "Bunari i Hajratit".

Haziri erdhi e më tha: "E kanë futur në sallën e operacionit dhe po e rrahin e po e pyesin gjithçka, por ai s'po flet dhe po e mban veten..."

Më vonë erdhi e më tha: "E hoqën nga salla dhe po e fusin në një pizgauer të ushtrisë. E kanë kapur dy vetë për këmbë e dy për duar. Zor që ka me shpëtuar!"

Andaj, nuk di a ka mbijetuar nga ajo dhunë, a ka mbetur gjallë?!

Tjetër çka di për të - di se ishte profesor. Por, nga ishte nuk e kuptuam asnjëherë", thotë Qazimi.

SI I SOLLËN NË KLINIKËN KIRURGJIKE-ORTOPEDIKE TË PLAGOSURIT NGA BOMBARDIMI NË LLUZHAN?

Ka qenë një storie tjetër me të plagosurit nga bombardimi i autobusit të firmës "Nish Expres", nga Nishi, mbi urën e Lluzhanit, bagazhi i të cilit ishte i mbushur me armatim, ndërkaq transportonte shqiptarë nga Podujeva për në Prishtinë.

Dhe, çka kanë përjetuar pacientët e plagosur shqiptarë nga bombardimi i NATO-s në Lluzhan, Qazimi thotë:

"Më kujtohet kur i sollën të plagosurit nga autobusi i bombarduar më 1 maj, mbi urën e Lluzhanit. Ishin të gjithë rëndë të plagosur dhe skena ka qenë e tmerrshme.

Të gjithë ishin të djegur, kishin ekstremite të dëmtuara rëndë. Kishin fytyra të djegura dhe të dëmtuara. Kishin shumë nevojë për trajtim profesional. Dhimbjet i kishin të padu-



rueshme.

Njëri nga të gjallët (N. J.) pyeste ku e kam babanë, vëllanë...

Mjekja, Zorica, me fytyrë të qeshur dhe me buzëqeshje të theksuar i tha: "Të kanë vdekur!".

Stafi mjekësor dhe infermierët ndaj tyre, po ashtu, janë sjellë në mënyrë barbare. Pacientëve shqiptarë nuk u është dhënë kurrfarë ndihme...

I kam dëgjuar mjekët serbë duke thënë: "Le të mbesin sa më shumë invalidë, se kështu e kanë kërkuar!", thotë bashkëbiseduesi.

MJEKU ME REVOLE...

"Më në fund, erdhi edhe momenti kur duhej t'mi hiqnin penjtë. Erdhi një mjek, e që kurrë nuk e kisha parë në klinikë. Me pincetë nisi të m'i hiqte penjtë nga varra, pa i prerë fare me gërshërë. Kisha dhimbje të padurueshme. Ai m'i shkaktonte qëllimisht dhimbjet, duke më hapur plagë të reja...

Dhe, pas dhimbjeve të mëdha që kisha, unë tërhoqa këmbën dhe mjeku serb nxori revolen. M'u kërcënoi dhe më tha se po e tërhoqa edhe një herë këmbën, do të flasë revolja...

Andaj, i durova dhimbjet, duke e shikuar revolen e mjekut me bisht të

syrit... Kisha përshtypjen se ai fare nuk ishte mjek...", tregon Qazimi.

SI E QEPNIN NJË FËMIJË NGA KAÇANIKU PA ANESTEZION?

Qazim Gashi, pacient në spitalin e Prishtinës gjatë kohës së bombardimeve, përshkuan disa nga ngjarjet që bënë serbët mbi shqiptarët:

"Reparti i tanishëm i syve në ORL ishte destinuar vetëm për pacientë shqiptarë. Me këtë veprim, serbët krijonin reparte etnike nëpër klinika. Kjo ndodhte për të ditur ku ishin pacientët shqiptarë... Rojet e reparteve, policët, paramilitarët, pinin dhe thyenin në repartin tonë. U thyen aq shumë shishe, sa u bë e pamundur të kalonim nëpër korridor...

Edhe një rast i rëndë: Ka qenë tmerr si e qepnin mjekët serbë një fëmijë nga Kaçaniku, 12 vjeç. Ai e kishte një plagë në shpinë dhe pranë i rrinte motra, e cila nga ndjenja e dhimbjes së britmës së vëllait që ia qepnin plagën pa anestezion, doli duke qarë nga dhoma. Djalit 12 vjeç nga Kaçaniku, që e qepnin për së gjalli, e mbante me sa fuqi kishte një serb tjetër.

Dhe, të dy i kishin hipur përmbi, si bishat...

Nuk di as për këtë djalë a ka dalë nga spitali, sepse e di që gjendja e tij shëndetësore rëndohej çdo ditë e më shumë... Sidoqoftë, çdo ditë serbët hanin, pinin dhe këndonin këngë çetnike në spital, duke i detyruar të këndonin bashkë me ta edhe disa pacientë shqiptarë! I detyronin ta këndonin këngën "Ko to kazhe, ko to llazhe (Kush thotë, kush gënjen)", thotë ai.

DALJA NGA SPITALI...

"Kanë qenë edhe tri vajza të plagosura në spital: njëra nga Burimi, tjetra nga Bërnica, kurse e treta nuk di nga ishte. Shumë i kanë ofenduar. I kanë fyer dhe keqtrajtuar. Po t'i shihja sot ata mjekë e ato infermiere, do t'i njihja pa fije dyshimi.

Sidoqoftë, ka qenë data 8 qershor kur ka ardhur një grua nga Mramori të më nxirrte nga spitali. Ajo kishte punuar aty më parë. Dhe, po t'mos ishte ajo, nuk do të kisha dalë i gjallë kurrë nga ai vend!

Sepse, çdo repart ka pasur roje strikte. Nuk lejohej dalja prej aty pa lejen e sigurimit", tregon bashkëbiseduesi ynë.

Safet Krivaça



Në Nabërgjan të Pejës

Pse Mire Lajçi *nga grua u bë burrë?*

Mire Lajçi, nga Nabërgjani i Pejës, në ditën që e vizituam, bëhej gati të nisej për në Bjeshkët e Nemuna, që ta shihte varrin e renovuar të babait, Metë Hajdinit. Dukej e gëzuar që do të shkonte në Rugovë, atje ku e ka kaluar gjithë jetën madhore, atje ku do t'i shihte përsëri bjeshkët e dikurshme ku ka bërë jetë bariu.

Mire Lajçi, 76-vjeçare, e ka vështirë të jetojë në Nabërgjan, ashtu siç do e kishte të vështirë jetën edhe në cilindo fshat tjetër, përderisa zanati i saj me bagëtinë, kryesisht me dele, është dashuria e saj jetësore, me të cilën është rritur e plakur. Ajo e pranon se i do delet shumë dhe kur i hoqi nga jeta e vet, e kishte përjetuar si vdekje. Gruaja që ka jetuar tërë jetën si

burrë, ka pranuar të sakrifikojë për familje. Ajo u bë krah i djathtë i familjes, duke e ndihmuar shtëpinë dhe babanë e saj për të mbajtur gjallë shtëpinë dhe familjen. Mire Lajçi e ka jetuar jetën si burrë dhe është sjell si burrë tërë jetën. Ajo edhe sot sillet si burrë dhe flet si burrat. Mban veshje burri, duke mbajtur në kokë plis, të mbështjellë me bez ngjyrë kafe.

Në shtëpi e duan shumë, pa marrë parasysh se asaj i duket ndryshe. Ajo nuk kishte besuar se do të vinte kjo ditë për të, edhe pse nuk është penduar asnjë çast që ka jetuar si burrë për ta ndihmuar familjen. Mire Lajçi thotë se në Rugovë, sa ka jetuar si çoban, askush nuk e ka thirr në emrin e saj Mire, por emri i saj ishte Kajta. Dhe, me emrin

Kajtaž ka bërë jetë, duke qenë e ashpër me të gjithë dhe duke i injoruar intrigantët, me të cilët ka qenë e pamëshirshme.

Ajo nuk e ka duruar askënd të sillet rreth saj, edhe pse tërë jetën ka jetuar duke pasur një rreth burrash, që kanë jetuar në malet e Rugovës.

Në ishin në shtëpinë e saj dhe, me këtë rast, zhvilluam këtë bisedë:

Sa vjeçe je?

- Jam 76-vjeçare. Po, çka keni me më pyet mua që kam jetuar tërë jetën si bari mali? I kam ruajt delet dhe s'di çka kam me tregua më shumë...

Sot, që ke këtë moshë, a je e penduar që nuk je siç ke mundur të jesh, duke pasur familjen tënde?

- Jo. Nuk jam penduar aspak dhe as që do të pendohesha ndonjëherë. Do bëja jetë të njëjtë edhe sikur të kthehesha po në atë moshë.

Si ka qenë jeta në Rugovë?

- Kam bërë jetë qejfi, jetë të mirë si çoban. Kam ruajtur tufën e deleve deri në 300 sosh, te vendi i quajtur "Guri i Kuq", afër Kuqishtës. Ka qenë jetë e mirë dhe nuk e kam ndërruar me asgjë.

Si ke arritur t'i ruash 300 dele në bjeshkët me ujë e arinj?

- Po, në Rugovë ka ujë e arusha, shumë bile. Nuk ka qenë lehtë me i ruajt 300 dele në bjeshkët ku nuk shihet as dielli, por i kam pasur qentë e fortë, e që u kanë bërë ballë bishave të egra... I kam pasur deri në 15 qenë e këlysh me vete...

A ke pasur edhe armë me vete?

- Pushkën e gjuetisë gjithmonë e kam mbajtur në krah deri në vitet 90, kur ma mori policia serbe, edhe pse e kam pasur me leje, me letra,

si çoban. Kur ma morën pushkën u mërzi ta shumë...

Çka të duhej pushka kur i ke pasur gjithë ata qenë?

- Pushkën e kam pasur për arusha. Ka pasur shumë arusha, e ato frikësohen nga krismat...

A je ballafaquar me arinj teksa i ruaje delet?

- Po-po, shumë herë jam ballafaquar me arusha fytas. Arusha e uritur të fshinë, është shumë e rrezikshme, të përlanë përpara... Kur e kisha pushkën e kisha më lehtë, sepse edhe natën kur u afroheshin staneve shtija në to dhe iknin, pa bërë shumë dëme në dele.

Por, pasi ma morën pushkën, u vështirësuan gjërat. U desh me e forcua mbrojtjen me qenë. Mirëpo, arushat janë të forta dhe u mëshonin qenve me shputat e këmbëve e me thonj...

Si ka qenë koha e luftës në Rugovë në vitet 1998-1999?

- Shumë e vështirë ka qenë koha e luftës në Bjeshkët e Nemuna. Malet u mbushën me ushtarë. E, serbët dogjën çdo gjë... Na i dogjën shtëpitë edhe në Malaj. Dhe, kur nuk na mbeti gjë, atëherë kam ardhur në Nabërgjan. S'kisha ku të shkoja tjetër...

Edhe tash, në pleqërinë time, e dua Rugovën dhe me Rugovë s'ka... Atje ka jetë se jo mahi...

Ke jetuar e vetme. A ke pasur raste që ke rënë në konflikt me ndonjë mashkull?

- Po, ka pasur shumë raste që kam rënë në konflikt me burra e çobanë, bile ka shkuar puna deri aty sa e kam kap hunin e u kam mëshuar ku kam mundur. Ka pasur raste që i kam rrahur derisa janë rrëzuar në tokë... S'e kam duruar askënd t'më ngacmoj. Nuk më kanë thënë kot-Kajtaž!

A i ke punuar gjithmonë punët e burrave?

- Po, gjithë jetën kam jetuar me burra dhe kam bërë punë burrash. Kam pre e qa dru. Kam pre dele kur ka pasur nevojë. Kam mbajtur pushkën në krah si burrat. Nuk ka punë burrash që s'e kam bërë. I kam mjel delet dhe kam përgatitur bylmetin.

A ke pasur leverdi me mbajtjen e deleve?

- Po, ua kam pa hajrin deleve. Pesë herë kemi blerë tokë nga paratë që merrnim nga delet. Në Rugovë, në Malaj e tutje, e edhe në Nabërgjan kemi blerë tokë. Në pranverë i shisnim qengjat dhe fitonim mirë, sepse qengjat e Rugovës janë të cilësisë së lartë dhe janë të kërkuar shumë.

Tani, që nuk ke më dele, a mërziresh për to dhe a të merr malli të jetosh siç ke jetuar në Rugovë?

- Thënë të vërtetën, shumë më merr malli për dele dhe ndjej nevojë t'i kem përsëri. Deri para dy vjetësh i kam pasur njëzet krerë dele, por edhe ato m'i shitën, sepse s'kishte kush t'i ruajë... Kur m'i kanë shitur delet e fundit, më beso, jam mërziur si edhe kur më ka vdekur baba...

Tash, ç'jetë bën ti?

- Nuk di ç'të them, kështu si jam tash, kurrqysh hiç! Jam si pa busull, sillem e mbështillem tërë kohën. Sa herë më bie të shkoj në Rugovë më mbushet zemra jetë. E, sot kam me shkua me pa varrin e babës që e kanë renovuar... Pjesën më të madhe të jetës e kam kaluar në Rugovë, andaj më merr malli të shkoj atje... Tash, në Nabërgjan, mbajmë lopë, por nuk është punë e imja, sepse shpirti më kënaqej në natyrë me dele...

S. Krivaça



Kush janë baballarët e qenve?

Qentë janë në modë! Në qytet e në katund, qenve po u vjen koha e vet. Kush është adhurues i tyre, ka nis të përbehet në qen. Konkretisht, im djalë, Dri-ni, kur betohet në qenin e tij, emri i të cilit është Tajson, e di se nuk po gënjën. Mua mund t'më bëjë be rrejtshëm, por qenin jo!

Qentë e kanë pushtuar kryeqytetin e Kosovës. Kah vije në punë, kudo në rrugë hasi në qenë. Konkretisht, rruga "Ali Hadri", në pjesën e vjetër të Prishtinës dhe pjesa e quajtur te Blloku" janë të mbushura me qenë!

Ata që kalojnë shpesh në këtë pjesë të qytetit sikur janë mësuar me ta, e ata që kalojnë rrallë këndej pari kanë frikë, sepse u vërsulën qentë...

Por, veç qenve që i hasim në rrugë, në këtë lagje të qytetit s'di të ketë familje që nuk ka qenë, e disa edhe nga dy! Një fqinj, që e ka shtëpinë afër Redaksisë sonë, çdo mëngjes shihet tek shkon në punë me qen! Një qen i vogël sa një mace...

Kur ai kalon pranë kafenesë ku pimë kafënë e mëngjesit, burra e gra qohen nga vendi për ta përqaftur qenushin! Secili e merr në dorë qenin e tij dhe e puthë në gojë e ballë...

Por, për çudi, edhe ai i puthë me gjuhën e tij të vogël...

PSE I DUA QENTË?

Edhe unë i dua qentë, por kam provuar të kem një distancë prej tyre, sepse shpesh kam qarë për qen kur ai është zhdukur, apo kur ka ngordhur, kuptohet, kur isha fëmijë.

Atëbotë kishte ligje dhe zakone tjera. Kur mbusheshin rrugët qen, si tash që janë mbushur, ftoheshin shoqatat

e gjahtarëve dhe urdhëroheshin t'i vrisnin.

Jepej alarmi në lagje se atë natë ishte aksioni për vrasjen e qenve dhe nuk lejohej të dilte askush në atë zonë.

E, pas mesnate, fillonin të dëgjoheshin krismat e pushkëve të gjuetisë mbi qentë endacakë. Aksioni zhvillohej deri në mëngjes dhe për një natë a dy pastrohej lagja e qentë barteshin me maunat e bërllokut dhe nuk i shihte më askush.

Dhe, me ardhjen e KFOR-it në Kosovë, gjithashtu, i vrisnin qentë. Mua, në fshat, ma vranë Galoshin, që e kishte shpëtuar nënën time nga një grup qensh pranë oborrit.

Pata qarë shumë, por ushtarët e KFOR-it finlandez nuk dhanë asnjë përgjigje. Por, nuk ishte vrarë vetëm qeni im, por të gjithë qentë që shiheshin jashtë oborrit të shtëpisë...

Dhe, po ato ditë vdiq një burrë në mëhallë, e që nuk ishte pak burrë, por burrë mbi burra.

Kur erdhi mixha Dullë e më pa duke qarë, më tha mos u mërzit se ka qenë burrë i vjetër...

Ishte menjëherë pas lufte. Sapo ishim kthyer nga Maqedonia dhe ende oborret nuk i kishim kositur nga bari. Unë i thashë xha Dullës se nuk po qaj për të ndjerin, por për Galoshin që ma vrau KFOR-i.

Atëherë, më tha:

"Ju qe keni shkuar në shehër jeni bërë si fëmija! A qan burri për qen, bre?!"

"Ma ka shpëtuar nënën, o xha Dullë! Ka qëndruar në shtëpi pas ikjes sonë në Maqedoni. Nuk e ka lënë shtëpinë tonë vetë... Është më besnik se ne që e lamë shtëpinë dhe ikëm..."

Ditën që u larguam nga shtëpia, erdhi me ne deri në fund të arave të kooperativës. Dhe, kur pa se ne veç ikëm, ai u kthye, nuk e braktisi shtëpinë...

Prandaj, po qaj për "Galoshin" e jo për xha Dullën!

BURRË E GRUA, NË VEND SE TË PUTHËN VETË, E PUTHIN QENIN!

Por, nejse...

Dashuria për qenë është bërë e madhe. Dalin burrë e grua për kafënë e mëngjesit dhe qenin e marrin me vete. E puthë herë njëri e herë tjetri. Dhe, në vend se ta puthin njëri-tjetrin, e puthin qenin!

Andaj, që t'i vrasim qentë më as që na bie në mend. Jemi në kohën që t'u kërkojmë falje atyre që u vranë në kohë lufte dhe pas saj...

Mirë është edhe t'u ngritim ndonjë event se ka pasur lloj-lloj qeni që, vërtet, ka merituar respekt dhe trajtim të mirë.

Por, tash rrugët e Prishtinës janë mbushur me qenë.

Shtrihen gjerë e gjatë shesheve të Prishtinës, e disa edhe kacafyten ndërmjet veti.

Sidoqoftë, qytetet tona janë mbushur me qenë, e katundet janë zbrazur prej tyre.

E, dikur ishte e kundërta... Në katund s'ka pasur shtëpi që s'ka pasur qen, e tash të rralla janë ato shtëpi në fshat që kanë qen, e në qytet nuk gjen shtëpi pa qen!

Andaj, shumë fëmijë janë sulmuar e kafshuar dhe kanë mbetur të traumatizuar nga qentë endacakë, që ka me bollëk kudo...

Sa gratë janë kafshuar nga qentë?!

E fundit që kam lexuar në portale, e që është sulmuar prej qenve, është mjeke e QKUK-së, e cila me të dalë nga puna është sulmuar dhe ka mbetur të kurohet në repartin e sëmundjeve infektive.

Kryetari i Prishtinës ka premtuar ndryshimin e gjendjes me qentë dhe ka thënë se do ta ngritë një strehimore të madhe, ku do të mbahen të gjithë qentë endacakë.

Por, kjo nuk po ndodhë e njerëzit janë viktima. Pra, qentë janë të paprekshëm, kurse për njerëzit që kafshohen nga qentë nuk e qanë kokën kush...

PA GRUA MUNDEM, PA QEN JO!

Por, nejse...

Kanë ndryshuar kohët. Për shumëçka ka ndryshime të mira e për shumëçka

ka të këqija...

Sidoqoftë, tash qentë janë në modë, si dikur pompat e benzinës. Kur dikush e bënte një pompë derivatives, menjëherë pranë tij tjetri ngritte një tjetër, në mënyrë që atë tjetrin ta nxjerrë nga tregu.

Dhe, teksa i kam në kokë të gjitha gjërat që i thashë, dy fqinjët e mi në Prishtinë flasin për qentë e tyre...

Ai që e ka qenin "Haski", i tregon tjetrit se çka ka të mirë te qeni i tij:

"Qeni im, komshi, natën i sheh qoftëlargët! Prandaj, e mbaj e nuk e humbi kurrë. E kam ble të vogël, sytë i ka të kaltër, natën i vezullojnë sikur xixëllonja..."

E, tjetri ia kthen:

"Qeni im, komshi, është belg. E kërcen murin si me qenë atlet. Trumcakun e ka kapur në ajër.

Nuk ka shans me hy dikush në shtëpi e me vjedhë..."

Prandaj, pa grua mundem e pa

"Haskun" jo..."

Por, kështu ishte edhe dikur, kur isha fëmijë. Kur nisnin të flisnin gjahtarët për zagarët e tyre, të dukej se është mbushur oda me zagarë...

Pra, keq atëherë e keq tash...

S. Murturi

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269336233 [/touristcamping_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269825858 [/giovannis_beach_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)

BOOM

*Çka thuhet
për meshkujt
e estradës?*

*Të famshmit
që nuk mund
të jetojnë pa
kafshët e tyre*

*Çfarë thonë
nishanet
për fatin
e Loredanës?*

Jeta Canaj,
damë e rëndë
që i hijeshon femrat

Jeta Canaj,

damë e rëndë që i hijeshon femrat

Jeta Canaj është femër e zonja, ambicioze dhe tejet e përkushtuar në profesion.

Jeta është tamam damë dhe këtë gjë e thonë ata që e njohin nga afër e larg.

“Studio Jeta”, e pronares Jeta Canaj, e hapur prej vitesh, ofron të gjitha shërbimet e mundshme të fushës së bukurisë.

Këtë studio e dallon përkushtimi ndaj secilës kliente dhe fakti se aty të gjitha ndjehen “si në shtëpi”.

Për jetën e saj dhe punën në “Studio Jeta”, flet vetë Jeta...



Jetë, pak fjalë për veten?

- Jam Jeta Cana, e lindur dhe e rritur në Prishtinë, ku edhe jetoj e punoj. Jam nënë vajzash dhe pronare e biznesit të bukurisë "Studio Jeta", adresë e njohur për të gjitha femrat që duan të duken bukur.

Po, jeta jote si është?

- Jetë normale. Jam shumë e dhënë, e përkushtuar e, madje, e dashuruar në punën time. Udhëheq këtë biznes bukurie me fluks shumë të madh të klienteve, të cilat dua që përherë të jenë të kënaqura. Gjithashtu, jam menaxhere e kompanisë "Martini" në Belgjikë. Krejt kjo është pak e lodhshme, por ia vlen.

Kur nise të punoje në fushën e bukurisë?

- Me këtë biznes merrem që 15 vjet dhe i jam përkushtuar me shumë zemër.

Salloni yt është i njohur. A të është dashur shumë punë për këtë sukses?

- Sigurisht. Nuk fakt, nuk besoj në sukses të mirëfilltë nëse aty nuk investohet shumë punë, mund e djersë.

Çka mendon se ka ndikuar më së shumti në suksesin në "Studio Jeta"?

- Puna profesionale dhe komunikimi staf-klient ka qenë çelësi i arritjes së suksesit në "Studio Jeta".

Kush janë emrat e njohur me të cilët punon?

- Kemi klientelë të gjerë, edhe shumë artiste që kurohen te ne. Mike të "Studio Jeta", ato që na vizitojnë më së shpeshti, janë, Violeta Kajtazi,

Shqipe Abazi e Ganimete Abazi-Ganja.

A kanë këngëtares më shumë kërkesa, a gëzojnë tretman më të veçantë te "Studio Jeta"?

- Në studion tonë të gjitha klientet gëzojnë respekt dhe tretman profesional e korrekt.

Pra, nuk ka trajtim më special për figurat publike, apo klientet e rregullta. Shumë respekt dhe përkushtim maksimal për secilën që i beson punës sonë.

Jetë, cili është pasioni dhe hobi juaj?

- Pa menduar dy herë, them: shëtitja dhe leximi.

Dukeni bukur, a i kush-toni shumë kohë paraqitjes së jashtme?

- Kujdesem mjaft për pamjen e jashtme, pasi e dua veten shumë. Në fakt, secila femër duhet të mësojë ta dojë veten dhe t'i japë vetes kujdesin e duhur.

Cila është pika jote e fortë si njeri?

- Besnikëria dhe karakteri.

Diçka pa të cilën mendon se nuk mundesh, nuk ia del?

- Nuk mundem pa përkrahjen dhe dashurinë e njerëzve që më rrethojnë, e që janë: nëna, vajzat dhe mbesa.

Gjithashtu, nuk mund ta imagjinoj jetën pa dashurinë që më dhurohet përditë nga njerëzit që më duan dhe i dua.

Kujt i falënderohesh për diçka?

- Falënderimi i takon Zotit për shëndetin dhe suksesin tim.

Për fund?

- Ejani në "Studio Jeta" dhe nuk do të zhgënjeheni!

N. N.



Çka thuhet për meshkujt e estradës?

Jemi mësuar të flasim shumicën e kohës për femrat e estradës, e gjithmonë t'i mbajmë në qendër të vëmendjes. Por, pa dyshim, edhe meshkujt e estradës bëjnë lajm e ngjallin interes.

ÇKA KA BUTRINT IMERI ME "KATUNDARËT"?

Është këngëtar i ri në skenën muzikore, por mjaft i pëlqyer nga të gjithë. Me punën e palodhshme, talentin dhe dashurinë e madhe që ka për muzikën, gjithmonë e bënë më të mirën. Këngëtari nuk dihet të jetë në lidhje, ndërkaq skandali që e shënoi këtë verë karrierën e tij është kur i quajti fansat katundarë!



LEDRI VULA PO INVESTON NË PATUNDSHMËRI

Ledri Vula, pa dyshim, bën pjesë në listën e meshkujve më të kërkuar nga publiku, e veçanërisht nga femrat. Karriera e tij shumëvjeçare ka bërë që të pëlqehet shumë nga opinioni i gjerë.

Ai është i pranishëm edhe në shumë koncerte, e që pothuajse gjithmonë është në qendër të vëmendjes. Ledri është i martuar, ka një vajzë dhe, së fundi, po investon kryesisht në patundshmëri.





GJIKO MES JETËS ME ELITËN DHE PROBLEMEVE TË SË KALUARËS

Asdren Gjiko, i njohur si Gjiko, është këngëtar dhe autor i njohur i këngëve, madje veçohet edhe për stilin e veçantë që ka.

Po ashtu, është i njohur edhe për bashkëpunimet e tij të suksesshme me këngëtarë të zhanreve të ndryshme. Është angazhuar me muzikë që në fëmijëri, ndërsa zhanri "Hip-hop" i fle në zemër. Edhe jeta private e këngëtarit është mjaft e përfolur. Martesa e tij me Elita Rudin prodhoi mjaft lajm. Së fundi, ka kaluar nëpër një valë problemesh dhe thashethemesh për një rast të së kaluarës së tij me një femër adoleshente.

GETOAR SELIMIN GRUAJA E BËRI "TIRONS"

Gheto Geasy është ndër reperët më të kërkuar dhe më të dashur nga adhuruesit e muzikës. Ai, së bashku me labelin e tij "Babas-tars" për vite me radhë mbajnë një pozicion tejet të mirë në industrinë e muzikës.

Me muzikë merret qysh në adoleshencë dhe sot e quan veten "baba i repit". Është i martuar me Marina Vjollcën dhe ka një vajzë. Çifti jetojnë në Tiranë.



CAPITAL T NË LIDHJE ME ADROLA DUSHIN

Capital T, po ashtu, është në listën e meshkujve më të kërkuar të es-tradës. I kërkuar në muzikë, por i kërkuar edhe nga gjinia e bukur. Prodhimtaria muzikore e këngëtarit, si përherë, është e kënaqshme dhe ai nuk ndalet së bëri më të mirën në karrierën e tij muzikore. Në jetën private thuhet se është në lidhje me Adrola Dushin.

N.

Të famshmit që nuk mund të jetojnë pa kafshët e tyre

Shumë prej këngëtarëve dhe aktorëve të ekranit shqiptar nuk e fshehin dot që i adhurojnë kafshët, madje disa prej tyre mbajnë kafshë shtëpiake. Dikush një qen, një tjetër mace dhe nuk është një surprizë që ata janë bërë miqtë e tyre më të mirë.

Dashuria e tyre për ta ka bërë që të tregojnë edhe për fansat, duke i publikuar fotot në rrjetet sociale.

Ja disa nga artistët shqiptarë që kanë kafshë shtëpiake dhe i adhurojnë ato...



MORENA TARAKU

Për shumë vite ajo shfaq gjithë dashurinë, e madje edhe adhurimin për qenin e saj të racës "Boo". Morena shfaqej kudo me Moin, madje ai bënte jetë luksi dhe kishte edhe faqen e tij në "Instagram".

Pasi Moi ngordhi, bukuroshja i ngriti lapidar dhe i bëri një dedikim të gjatë e emocional.

LEDRI VULA

Ledri Vula është rritur me praninë e kafshëve në shtëpinë e gjyshërve dhe në shtëpinë e tij. Ndërkohë, meqë te gjyshi kishte mace, në shtëpinë e tij mbanin dhe vazhdojnë t'i mbajnë disa qenë.

Ledri është tejet i lidhur me qentë e tij, me të cilët kalon mjaft kohë.



KIDA

Kida është ndër këngëtarët e reja më të pëlqyera. E, asaj i pëlqen shumë qeni i saj i racës "Shpicer Gjerman", me të cilin Kida kalon mjaft kohë.

Këngëtarja është shumë e lidhur me qenin e saj që e mban në banesë, e për të cilin kujdesen, kryesisht, prindërit e këngëtares.

Kida është parë shpesh duke i dhënë puthje e përqa-fime qenushit, e madje edhe duke ja festuar me tortë ditën e lindjes.



FIFI

Ndoshta nuk e keni ditur, por edhe Fifi është mjaft e dashuruar në qenin e saj, të cilin e nxjerrë kohë pas kohe në rrjete sociale.

Por, nuk është nga ato këngëtare e figura publike që çdo foto e kanë me qenin a macen.



BEATRIKS RAMOSAJ

Në këtë mes nuk mund të përjashtohet këngëtarja e njohur, Beatriks Ramosaj, dashuria e së cilës ndaj qenit të saj është e jashtëzakonshme.

Të gjithë e dinë se sa e afeksionuar është bukuroshja ndaj Bellës së vogël, qenushes që disa herë u bë pjesë e "Big Brother Albania VIP".

N.



/white_bubble_hotel

Çfarë thonë nishanet për fatin e Loredanës?



Loredana Zefi, nga Ferizaj, ka arritur të bëjë famë në tregun muzikor shqiptar dhe atë gjerman. Madje, atë e njohin dhe e dëgjojnë në vende të ndryshme të Evropës, bile ka fituar edhe çmime në "MTV EMA".

Loredana ishte në lidhje serioze me reperin Mozzik dhe ka një vajzë, e cila është dashuria e saj e madhe.

Dhe, ndonëse është ndarë me Mozzik, po flitet se është në lidhje me Noizyn.

Rep-artistja gjithë trupin e ka me nishane, Ndërkaq, në popull thuhet se kush e ka trupin me nishane ka fat.

Pse nuk mund të harrohet

Agnesa Vuthaj?

Ish-"Miss Peja", "Miss Kosova" e "Miss Albania" dhe përfaqësuesja e Shqipërisë në "Miss world", vazhdon të shkëlqej.

Për një kohë të gjatë Agnesa Vuthaj ishte tejet aktive në fushën e modelimit dhe në aspektin medial, por jo më. Ka kohë që Agnesën nuk e kemi parë të përfshirë në kampanja, apo aktivitete të ndryshme.

Megjithatë, ajo vazhdon të duket e freskët, e bukur dhe tamam mis.

E, kush mund ta harrojë Agnesën?



Ardit Stafa dikur yll i muzikës. Ku është sot?

Ardit Stafa është një nga emrat e paharruar të skenës sonë muzikore. Me shumë këngë, çmime në festivale dhe me pjesëmarrje të ndryshme televizive, Ardit Stafa për një kohë ishte ylli i botës së muzikës.

Por, ka kohë që Arditi nuk shihet gjëkund.

Megjithatë, ai është aktiv në rrjetin social "Instagram", ku kohë pas kohe poston fotografi dhe video të ndryshme. Arditi nuk e ka ndalë aktivitetin artistik, të cilin, megjithatë, mediet e postojnë shumë pak, pasi nuk është komercial.





A ta pres të dashurin tim që është në burg?

Jam 20- vjeçe, jetoj në Viti. Tre vjet më parë jam njohur me një djalë. Ai më telefonoi rastësisht dhe nisëm të flisnim bashkë. Në fillim nuk e kisha merrja seriozisht, madje bëja shaka dhe tallesha, por me kalimin e kohës bisedat me të nisën t'më pëlqenin.

Unë nuk kam shumë shoqe, për të mos thënë se nuk kam asnjë shoqe, pasi jetoj në periferi dhe nuk guxoj të ndaj diçka me një vajzë të qytetit tim, sepse ajo do ta flasë me një tjetër. Duke parë se në Viti njerëzit të

përgjojnë shumë dhe sa shpejt hapen thashethemet, aq më pak mund të kesh një shok.

Kështu, e kisha më të thjeshtë që t'i ndaja gjërat që më ndodhnin dhe hallet e mia me një të panjohur, me të cilin flisja vetëm në telefon.

Kaluan gjashtë muaj nga koha kur nisa të flisja në telefon me Lulin dhe pas këmbënguljes së madhe të tij që të takoheshim pranova. Sajova disa gënjeshtër shtëpi dhe shkova në Ferizaj për ta takuar. Ishte djalë simpatik dhe më pëlqente të flisja me të. Më kuptonte dhe e kuptoja ose, të paktën, kështu thoshte ai.

Pas asaj dite takimet tona bëheshin më të shpeshta dhe mua më pëlqente gjithmonë e më shumë. Në një nga takimet tona të fshehta Luli më puthi. Isha shumë e lumtur, sepse kishte kohë që prisja të ndodhte diçka e tillë. U ktheva e lumtur në shtëpi dhe nga ajo ditë vetëm ëndërroja sesi

do të ishte jeta ime me Lulin, se sa shumë e doja atë njeri dhe mendoja se më prisnin vetëm gjëra të bukura në të ardhmen, por nuk ishte kështu.

Të gjitha ëndrrat e mia do të shuheshin më vonë. Gjithsesi, kemi qëndruar një vit bashkë, takoheshim më shpesh, deri sa Luli kërkoi të bënim dashuri bashkë. Edhe pse kisha frikë dhe mendoja se pas kësaj gjërat mund të ndryshonin mes nesh, unë e doja Lulin dhe isha e gatshme të bëja gjithçka për të.

Fjetëm bashkë dhe ai u tregua shumë i dashur me mua. Asgjë nga ato që më frikësonin nuk ndodhën...

RA NJË TELEFONATË DHE NDRYSHOI JETA IME!

Ne vazhdonim historinë tonë të dashurisë. Në një nga këto ditë, kur prisja me pa durim takimin e radhës me të, më vjen një tele-

fonatë. Ai më tregon se mund të ikte jashtë për pak kohë, por unë nuk duhet të mërzhitesha se do të kthehej pak muaj më vonë dhe do të martohej me mua.

Ishte hera e parë që dëgjoja të fliste për martesë, por nuk munda të gëzohesha nga ky lajm, sepse më shqetësoi shumë fakti pse kishte vendosur papritur të ikte jashtë.

Ngula këmbë t'më tregonte të vërtetën dhe ai më tha se ishte grindur me një djalë tjetër dhe sherri kishte përfunduar keq. Ai më tha se në gjaknxehtësi e sipër ishte përleshur me një djalë dhe kishte ikur me shpejtësi, pa e kthyer kokën pas.

Ai më tregoi se e dinte mirë se familja e tij do të hakmerren, andaj zgjidhja e vetme për të ishte ikja jashtë.

Pas asaj telefonate nuk mund të tregoj me fjalë se sa shumë u

copëtua zemra ime. Ai tani do të ikte jashtë, por nëse nuk kthehet më çfarë do të ndodhte me lidhjen tonë?

Kjo ishte frika ime më e madhe dhe, në fakt, kështu ndodhi...

Ai iku jashtë dhe me muaj të tërë nuk m'u paraqit fare. Dhe, kur m'u paraqit, për çudi, më tha se paraqitej nga burgu në Sllovaki, sepse ishte kapur në kufi duke kaluar kufirin ilegalisht.

VETËM NJË ZOT E DI PSE ËSHTË BURGOSUR!

Ai tani ka një vit në burg dhe nuk dihet se kur do të lirohet dot. Ai më lutet ta pres, sepse avokati i ka thënë se mund të lirohet brenda një kohe të shkurtër dhe do ta kthejnë në Kosovë.

Por, ekziston edhe mundësia që ai të bëjë ndonjë dredhi dhe të ikë

nga burgu e të kalojë në ndonjë vend tjetër...

Unë nuk di çfarë të bëj! Ndihej shumë keq për këtë që ka ndodhur dhe qaj pa pushim.

Sidoqoftë, e dua shumë Lulin, por mendoj se sa e vështirë do të jetë të pres kot, madje edhe pa ditur se a do të kthehet ndonjëherë...

Në anën tjetër, mendoj se pas daljes së tij nga burgu gjërat mund të ndryshojnë, mendoj se ndoshta ai nuk do t'më dojë më kur të dalë, apo mendoj se edhe në mua mund të ndryshojnë ndjenjat për të...

Pavarësisht të gjithave, ajo që më shqetëson më shumë është familja ime, e cila nuk do të pranojë kurrë që unë ta lidhë jetën me një djalë që ndodhet në burg.

Sepse, fjalët e hallkut e birat e gardhit nuk mbyllën dot...

V.V.



DIKUR...



Lakeside Hotel
Hotel resort

For reservation:
+38348808408
www.lakesideks.com



Është koha të bëheni
me banesë të re!

-10%

ZBRITJE

www.cimaks.com

E ku ka më mirë se në vendlindje...

CIMA
Construction

[f](#) [@](#) [globe](#) www.cimaks.com



A jetohet gjithmonë me një grua?

Çdo lidhje dashurie i ka edhe problemet e veta, e disa janë edhe të patejkalueshme dhe jeta në çift plasaritet. Të anketuarve ua bëmë pyetjen: A jetohet gjithmonë me një grua apo vetëm me një burrë?

RIFADIA, PROFESORESHË:

ZEMRA NJË HERË FALET!

- Jeta nuk është e gjatë dhe të mbajmë zi për atë që e kishim dikur në krahë e nuk e kemi më... Nëse ia falë, ai përsëri do ma bëj edhe më zi, sepse ke të bësh me të njëjtin njeri. Jo, nuk do të pranoja të rikthehem, sepse zemra një herë falet, e nuk do ia vrente të rifilloja me të njëjtin përsëri. Mbetët e kaluar ajo çfarë përjetuam bashkë, tani është i lirë dhe le të kërkojë dashuri të re, tjetër, se për mua ai do të jetë i vdekur...

FLAKA, EDUKATORE:

NUK DO E LEJOJ TË LUAJ ME NDJENJAT E MIA

- Meshkujt janë të atillë që vetëm pas humbjes së personit të dashur e kuptojnë vlerën e tyre. Dhe, do ishte absurde ta prananim një gjë tillë, ngase, si sot e si nesër, përsëri do të bënte të njëjtat gabime. Nëse njëherë e kam lejuar të luaj me ndjenjat e mia, nuk do të nguronte ta bënte prapë të njëjtën gjë, sepse, po të kishte respekt dhe dashuri në

atë lidhje, nuk do të ishim ndarë dhe është e papranueshme nga ana ime.

VERANDA, DIZEJNATORE:
DOJA T'I KTHEHESHA, POR NUK PRANOI

- Sa shumë doja ta pranonte ofertën time edhe një herë ish - i dashuri im pas ndarjes sonë, por ishte e kotë, ngase nuk donte as të fliste me mua, e lëre më të jemi bashkë. Jeta e tij kishte marr kah tjetër, me një person tjetër dhe më unë nuk bëja

pjesë në zemrën e tij... Dhe, e tëra ndodhi me fajin tim. Ua pafsha hajrin paso-jave! Një gjë e kam të qartë: kurrë asnjëherë nuk do ta dua dikë siç e desha atë, por tani është vonë dhe çdo fjalë që e flas është e tepërt, e kotë.

ARDIANI, KAMERIER: NUK JETOHET GJITHMONË ME NJË GRUA!

- Vajzat e mbajnë krenarinë shumë dhe i shtypin ndjenjat. Ato nuk flasin gjithmonë çfarë u thotë zemra. Çdo-kush gabon, andaj edhe ne, si të rinj, gabojmë dhe duhet të kemi edhe rastin për t'i përmirësuar gabimet. Sikur të isha në vendin e saj, unë do ia falja gabimin dhe do e pranoja të jetë me mua, ngase prej një gabimi mëson. Nuk është mirë të nisemi nga ajo që ka njerëz të përkryer dhe nuk ka vend për gabime, kjo është gjë e pamundur, ngase një ditë e kupton se edhe për të është e rëndë të jetojë me dikë që nuk ta do zemra.

VLERA, FARMACISTE: ZEMRA E LËNDUAR NUK SHËROHET...

- Ndarja vjen vetvetiu... Dhe, nëse njëherë ndodh ndarja dhe prapë mendon të kesh një lidhje të shëndoshë po me atë person, vetëm gabohesh, sepse nëse njëherë të lëndohet zemra është shumë vështirë të shërohet. Andaj, rikthimi i të njëjtit person në jetën tënde nuk ia vlen, ngase ai është i njëjti dhe nuk e meriton të merresh më me të.

VIRANI, LABORANT: KU PËSHTYJ NUK LËPIJ!

- Aty ku pështyj ma nuk lëpij. Nuk thuhet kot: Nuk të

ngrohë dielli i dimrit si ai i verës! Prandaj, nuk ka vend për falje. Pra, të kaluarën le ta merr pluhuri i harresës ngase po t'u thye zemra njëherë dhe pikon loti për dashuri, nga ajo lidhje s'mund të ketë asgjë më veç dhimbjes.

GJINI, PUNËTOR ADMINISTRATE: NËSE KËRKONI FALJE, ZGJIDHEN PROBLEMET...

- Për dashuri ia vlen të sakrifikosh çdo gjë, sepse nuk thonë kot se dashuria është gjëja më e shtrenjtë në jetë, andaj ajo të shtyn të veprosh edhe jashtë vetes. Mendoj se secila femër, përball një personi që e dashuron me zemër, do harronte çdo gjë, madje edhe vuajtjet e shkaktuara. Mendoj se ka kthim mbrapa për të mirën e dyanshme dhe unë personalisht do e pranoja ofertën e saj nëse një ditë do t'më ndodhte një gjë e tillë edhe mua. Pra, në dashuri ka vend për falje dhe ajo do i zgjidhte problemet e krijuara.

PËR FUND

Dashuria i mund të gjitha, madje edhe vuajtjet që i shkakton ajo. Secili nga ne mund të gabojë, ndoshta, edhe pa dashje dhe nga një gabim nuk është e mirë të vuani gjithë jetën, ngase një ditë mund të pendoheni, por, pa dyshim, do të jetë vonë... Andaj, lëreni inatin anash, siç tha njëri nga të anketuarit, se dashuria është gjëja më e shtrenjtë në jetë. A nuk do ia vlente një kërkim-falje për një dashuri të madhe dhe t'i harroni të gjitha, të jetoni të lumtur si dikur?

Diturie Haxhaj



Si e kalojnë jetën ata që i kanë nga dy gra?

*Shqiptari që një javë fle me
njërën grua, një javë me
tjetrën!*

Historia e Demë Mulës, 63-vjeçar, nga fshati Dobrun i Hasit, nuk është unikat, por është ndër historitë e rralla te shqiptarët. Ai jeton në të njëjtën shtëpi me dy gra.

Pas gruas së parë, Hatixhes, e që nuk lindi fëmijë, Dema vendos të marrë një grua të dytë, Nazmijen. Por, as me atë nuk arriti të ketë fëmijë. Andaj, vendosi t'i mbajë të dyja. Gratë e Demës shprehen se nuk kanë xhelozin ndaj njëra-tjetrës, madje bashkëshortin e tyre e ndajnë në mënyrë të barabartë, por që flenë në dhoma të ndara.

"Çifte si ne ka sa të duash dhe ne s'jemi as të parët e as të fundit", thotë Hatixhja.

Ndërkaq, Dema shprehet:

"Ne, që i kemi nga dy gra, në anën e Hasit e kemi zakon një javë flemë me një grua dhe një javë me tjetrën".

Shtrohet pyetja: Sa çifte të tillë ka në Kosovë dhe si e kalojnë jetën ata që jetojnë me nga dy gra?

Cilat janë politikanet dhe moderatoret tona beqare?

ELIZA HOXHA

Dikur këngëtare shumë e njohur dhe e adhuruar, fotore-portere dhe arkitekte e dalluar, e tash deputete e zellshme. Kjo është Eliza Hoxha, e që njihet për përkushtimin e saj në punë, për stilin e saj të veçantë.

Por, si qëndron statusi i saj?

Eliza asnjëherë nuk ka treguar për jetën private, edhe pse ka pasur thashetheme që e lidhnin me figura të ndryshme, kryesisht publike, por asgjë konkrete.

“Dashuri perfekte s’ka, por perfeksioni mbështjell një dashuri atëherë kur e adhurojmë dhe e dashurojmë personin tjetër me gjithë anët e mira dhe të këqija që ka. Atëherë dashurojmë sinqerisht”, tha kohë më parë ajo.



LIBERTA SPAHIU

Fotografi i njohur shqiptar, Fadil Berisha, Liberta Spahiu e ka quajtur një “Bond Girl”, gjatë një sesiioni fotografik në plazhet e Dubait.

Megjithatë, ish-modelja, Liberta Spahiu, që tani drejton emisionin “Prive”, edhe më tutje mbetet në krye të top-listës si moderatore me bukuri të rrallë, për angazhim dhe emision shumë të suksesshëm.

Por, enigmatike është jeta e saj private, meqë, përveç fjalëve, nuk ka pasur asgjë konkrete asnjëherë.

Por, në këtë temë nuk janë vetëm këto të dyja që i zëmë në gojë, meqë ka edhe shumë të tjera, që i lëmë për herë të tjera...

PHI LINGS
ARBNORE GEGOLLAJ



[f](#) /StudioLolaOfficial

[i](#) /phi.arbnoregegollaj

Adresa: Përballë Komunës Malishevë ; Kontakti: +383 49 573 896;

4 vjet martesë dhe ende e virgjër!

Jam veshur si nuse me buzëqeshje në fytyrë, por brenda jam duke vuar, sepse që katër vjet jam martuar dhe ende jam e virgjër! Sepse, që katër vjet martesë im burrë asnjëherë nuk më ka prekur me dorë!

Jam 25-vjeçare. Para pesë vjetësh u njoftova me një djalë nëpërmjet shoqes sime, shkaku se familja ime nuk më linin të dalë e lirë dhe ta gjej fatin e jetës sime.

Dhe, pas një kohe edhe u fejova me të, kuptohet, me pëlqimin e të dy familjeve tona.

Por, pas fejesës i fejuari im shkoi në Gjermani, ku qëndroi një tre muaj e jo më shumë. Por, kur u kthye gjithçka ishte ndryshe: më ofendonte shumë dhe çdo gjë imja e pengonte! Dhe, erdh koha e u martuam me një ceremoni mesatare martesore.

NATËN E PARË TË MARTESËS E KALOVA SI PA BURRË!

Por, as natën e parë e as për vite me radhë burri me dorë s'më ka prekur! Pra, jetoj me të që katër vjet, kurse

asnjëherë s'kemi pasur marrëdhënie seksuale!

Mirëpo, nuk e bëja këtë gjë të madhe, duke thënë: Hajt, se Zoti e bën mirë! Megjithatë, pas një viti familjes sime ua bëra me dije se ne flemë si vëlla e motër...

E, ai nuk di çka u ka thënë të vetëve, meqë nuk më thoshte gjë...

Por, gjithmonë më thoshte se jam nuse e mirë, se i prit mysafirët mirë, se nuk flas shumë, e të tjera të ngjashme. E, këto mua nuk më mjaftonin, sepse kisha nevojë biologjike. Pra, kisha nevojë të kënaqesha...

NUK E DESHI AS MJEKUN E AS HOXHËN!

Disa herë i thashë burrit të shkojmë te naj mjek dhe të kontrollohemi, e pse jo edhe te naj hoxhë e të shkruajmë, sepse gjërat nuk po na shkojnë mirë, kurse ai thoshte se çdo gjë

është mirë...

Dhe, me kohë e pashë se kot më shkonte jeta, pa marrë asgjë nga ajo, se humbja çdo ditë e më shumë, se s'dija çka ishte kënaqësia.

Më në fund, edhe familja më tha të ndahem nga ai...

Andaj, ashtu edhe veprova...

Mirëpo, deshi fati dhe një ditë njoha një njeri në "Facebook" dhe nisëm të komunikim ndërmjet veti.

Në fillim nisëm të flisnim për jetën, për hallet tona, pra krejt shoqërisht. Mirëpo, ai nuk po merr ndonjë hap tjetër që ta konkretizojmë lidhjen tonë.

Po frikësohem se edhe ky mos është si ai, i pari, sepse, si duket, fatin e kam të tillë!

E, kështu, si po rrjedhin gjërat, nuk shoh gjë as nga ky, andaj jam në hall se çka të bëj...

Virane A.



Kur jam ndie më së keqi në jetë?

Para një viti tim mik iu martua djali. Nusja ishte me shami. Jetonin jashtë të dy. Shkuam ta vizitonim, meqë kishin ardhur për të parën herë në Kosovë si të martuar. Nusja e re, me shami ngjyrë kafe, u afrua. Ia zgjata dorën. Ajo dorën askund! Më mbeti dora lart... U ndjeva keq, shumë keq...

"Heu, ç'dreqin bëra kështu?!", e solla në mendje. Edhe një gabim, i thashë vetes, se djalli nuk përmendet pranë kësaj myslimaneje. Por, unë si unë dhe tek më rri djalli në buzë, nuk mundem pa e pyetur renë e tim miku: "Kam dëshirë të di më shumë për fenë: Pse ka mbetur të mos ia jep femra dorën burrit të huaj?". Ajo, pasi i rrudhi krahët, tha: "Kështu jemi marrë vesh me burrin dhe kështu është më mirë. Ka lloj-lloj burri. Dikush ta shtrëngon dorën, dikush mund ta luajë gishtin në dorë e dikush mund të gjestikulojë lloj-lloj sjelljeje dhe vjen te problemi. Prandaj, më mirë që e kanë lënë të flitet me burra nga distanca. Më hajër është kështu!".

ÇKA S'PO NDODHKA ME SHUPLAKAT E BASHKUARA!

Heu, them me vete, kjo po i dika të gjitha që mund të ndodhin brenda dorës së gruas dhe të burrit, nuk qenka fija që kjo nuse nuk di çka mund të bëhet brenda dy shuplakave të përqafuara. "A thua, nuse, a janë të gjitha kaq të nder-shme e të ditura si ti?", i thashë. "Ka gjithçka, ne jetojmë jashtë, atje është një civilizim i lartë, mund të ketë gjithçka. Nuk i shtie duart në zjarr për askënd, sepse jeta sjell të papritura të rënda dhe mirë është të flet njeriu vetëm për vete", foli ajo. Shih sa mirë? Me vend, plotësisht, kur dikush flet vetëm për vete, por aspak shqiptarçe ky stil, sepse ne e kemi zakon



të flasim për të tjerët. Për të gjithë kemi nevojë të flasim, por për veten tonë jo. Por, as kjo nuk mbetet keq, sepse për ne, gjithashtu, flasin të tjerët. Asgjë për atë botë nuk mbetet, thotë populli, dhe të gjitha pastrohen në këtë botë.

PËR NJË ULTRAZË DUHET TË PRITET NJË MUAJ!

Por, ka edhe më keq. Shkon A. K., 47 vjeçe, te mjeku në shtëpinë e urgjencës në Prishtinë, nën Lagjen "Ulpiana" dhe e viziton doktoresha që nuk po ja zë emrin në gazetë. Pacientja me dhembje të mëdha të veshkës i bën analizat urgjente në një laborator. Pacientja ia kthen analizat doktoreshës, e cila konstaton se diçka me urinë nuk është në rregull, por i rekomandon injeksion kundër dhimbjeve, me kusht që nesër para dite të bëjë një ultrazë te internisti, e që qenka femër. Dhe, të nesërmen ajo shkon te internisti.

"Dua një ultrazë ta bëj me rekomandimin e mjekes", i thotë ajo.

"Doktoresha e di se këtu është vetëm me termin dhe unë terminin po ta caktoj për datën 6 mars", i thotë motra mjekësore. "Duhet të pres me këto dhimbje aq gjatë për një ultrazë?!", i thotë.

"Nëse nuk të pritët, shko ku të duash!", ia kthen motra.

Pacientja detyrohet të shkojë privatisht ta kryejë ultrazërin për të marrë terapinë e ndaljes së dhimbjeve.

Por, çka nëse nuk do të kishte pasur para? Me siguri, duhet ta kishte duruar dhimbjen për dhjetë ditë... Matematikë e rëndë apo jo? Kjo është matematika e tragjikes së shëndetësisë kosovare...

Por, çka nëse pacientja do të vdiste nga dhimbja? Kush do të përgjigjej apo kush do ta pranonte fajin? Me siguri, askush... Faji jetim, si gjithnjë, ndërsa pacientët e hanë të keqen.

S. M.



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

ABONORA

DRYMADES



*Në Shqipërinë e jugut,
Dhërmiun e bukur!*



Rr. Perivolo, Dhërmi, Shqipëri
+355 69 342 5090



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamt, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamt.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamtin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



contact@lavieenrosedarling.com
www.lavieenrosedarling.com
 /lavieenrosedarling



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A do të shkoj në Perëndim?

E dashurua magjistare, jam lexuese e rregullt e rubrikës tënde. Jam nënë e një fëmije. Jam 36 - vjeçare. Ka kohë që ëndërroj të jetoj jashtë Kosovës, por nuk di a do t'ia dal këtë qëllimi. Premtime kam nga një person me të cilin familja ime ka lidhje miqësore dhe ne besojmë se ai nuk do na zhgënjë.

Të lutem, mos i publiko emrat e as të dhënat tjera, sepse e lexojmë rubrikën tënde dhe nuk duam të kuptohet kjo gjë.

Si e sheh ti këtë premtim të mikut tonë për të dalë jashtë shtetit dhe çka të bëj, sepse nëse shkoj atje e humbi punën këtu ku jam tash?

"Familja falënderuese"

Përgjigje:

Dyshoj se mund të arrish atë që u ka premtuar miku juaj, madje nuk do ta quaja mik të plotë dikë që është lidhur me interes me ty dhe familjen tënde. Ai po punon pas shpine dhe nuk e quaj shumë miqësor këtë sjellje të tij, prandaj merri si të kufizuara këto premtime.

Je e punësuar dhe me përgatitje superiore dhe i di kriteret e vendeve të BE-së për qëndrim. E di se si mund të arrihet qëndrimi atje. Një gjë e tillë mund të arrihet vetëm duke u kurorëzuar me ndokënd që jeton atje, diçka ngjashëm si po e provon ti me personin që po të premtton. Shoh se nuk është vetëm një premtim për të

tërhequr në atë shtet, por më shumë është një insistim juaj të afroheni, sepse dashuria nuk njeh kufi, por as moral, e ajo që ju korit është lakmia. Sugjerimi im është: mbani punën këtu dhe ruani familjen, sepse burri yt nuk është për të shkuar ti atje. Nëse ai që t'i jep ty letrat dhe kurorën të mban minimum katër vjet për t'i fituar ti letrat, po aq vite duhesh edhe ti t'i kushtosh burrit tënd që të arrij të vjen te ti. Pra, do të kalojnë afro dhjetë vjet derisa të bashkoheni përsëri...

A do të largohet vajza nga çeku?

Jemi familje që jetojmë në Gjermani që dyzet vjet. Nuk kemi pasur probleme asnjëherë, por gjenerata e tretë e jona këtu ka bërë që shumëçka të harrojmë prej adeteve tona.

Ka pesë muaj që vajza jonë shkon me një djalë çek dhe ne po frikësohemi se ajo do të martohet me të, sepse na ka thënë se nëse e pengojmë martesën ajo do të shkojë me të të jetojë në qytet tjetër ose te ai në shtëpi të tij.

Duam ndihmën tënde, sepse kemi shumë hall familjar, pasi do të na ndodh ta humbim një vajzë, meqë babai thotë se nëse ajo martohet me të, më nuk e pranoj në shtëpi. Çka të bëjmë?

"Gjermania"

Përgjigje:

Para së gjithash, keni pak durim dhe mos e merrni me të keq vajzën. Lid-

hja e tyre ka krijuar atë nivel ndjeshmërie sa secila përpjekje juaja që ta largojë vajzën me çdo kusht prej tij, sjell ngulfatje të procesit. Duhet t'i sillni asaj më shumë argumente mbi traditën tonë martesore dhe ta bindni se nuk do të bëhet kiameti nëse ajo largohet prej tij dhe pastaj e gjen një djalë tjetër me të cilin e lidhë ana socio-psikologjike dhe familjare më shumë se me çdokënd tjetër.

Ku do të jetoj?

Jam P. G., 23 – vjeçar, lexues i rubrikës tënde. Të kam shkruar para do kohe dhe më ke thënë se do të arrij të dal jashtë. Ka shumë raste kur po më humbet vullneti për të jetuar.

Ku do të jetoj?

"Shpresat e jetës"

Përgjigje:

Ti je i ri dhe kur ke shkruar letër, me siguri, të kam thënë se ekziston mundësia jote me dal jashtë, sepse i ke të gjitha predispozitat që t'i lejon moshën. Këtë rrugë ti mund t'ia sigurosh vetvetes me iniciativën tënde.

Njeriu atë që e kërkon e arrin në jetë, por duhet të posedosh këmbëngulësi dhe të mos dorëzohesh para sfidave që sjell koha. Ti e di se sa është vështirë të kyçesh në një shoqëri me një rend tjetër shtetëror dhe demokratik.

E, ato ndryshime nuk janë të lehta, sepse, së pari, fillohet nga të folurit (gjuha) dhe integrimi në atë sistem që nxjerr nga jeta e vet 90 për qind të mënyrës paraprake të të jetuarit social, folklorik, historik dhe popullor të traditës. Kjo tregon se janë një numër gjërash që krijojnë një kompleks të tërë jete, e që krijojnë shumë sfida e mundime për t'u bërë shtetas të një vendi tjetër me traditë të ndryshme nga ajo ku ke jetuar nga fëmijëria.

Shtetet e BE-së, për shembull, i kanë mënyrat e veta për ta arritur

këtë integrim për njerëzit që shkojnë të jetojnë atje.

Më mungon dashuria

E dashura magjistare, jam M. K., 23 – vjeçare, nga Shtimja. Më mungon dashuria.

A do të kem fatin ta zgjidhi këtë problem dhe kur?

“Shpresa”

Përgjigje:

Problemi yt nuk mund të zgjidhet në shpejtësi. Duhet të keni durim, por edhe të keni përkrahës për ta mbaruar pozitivisht këtë proces. Deri në muajin dhjetor shoh se do të keni sukses, por mos e merrni edhe si punë të kryer, sepse pengesat e shfaqura janë bukur vështirë të evitohen. Nëse këtë problem nuk arrini ta shthurni këtë vit, fatin kërkoje në pjesën e parë të vitit 2023.

Na mungon fati në familje

Përhëndetje zonjë e nderuar. Jam lexuese e rregullt e rubrikës tënde, ku gjejnë shërim, ndihmë dhe zgjidhje të problemeve shumë njerëz.

Në familjen tonë jemi 11 fëmijë, por disa tëmartuar e disa jo... Në këtë gjendje si jemi sot, nëna po mërzhitet shumë, ndërsa babai ka vdekur qysh moti. Në aspektin moral jemi familje e ndershme dhe kurrë askujt keq nuk i kemi bërë, pos që kemi bërë të mira dhe humanitet dhe kemi ndihmuar edhe të varfër dhe jetimë. Kemi në tërësi një disiplinë familjare që pakkush mund ta ketë, por fati na mungon të gjithëve. Jemi në gjendje të rëndë depressive. Kemi mbetur t’u lakmojmë atyre që i shohim se janë të lumtur dhe të harmonizuar në punët e fateve. Ju lutem, çka po ndodh në familjen tonë? A kemi magji në shtëpi?

“Të besoj shumë”

Përgjigje:

Keni krijuar kompleks psikik se diçka po ndodh me punën e fatit

në shtëpi. Ndarjet që kanë ndodhur janë pjesë e jetës...

Megjithatë, jeni bërë me shenjë në rrethin tuaj dhe ajo çka mund t’u them është se edhe bash pa asgjë të keqe nuk jeni në shtëpi. Te ju ndodhin ndarjet për hiç gjë. Nuk ka qenë adet me u nda çiftet për një fjalë goje apo për diçka të vogël, sepse jeta është e ndërtuar prej gjërave të imta që e përbëjnë një tërësi të vetme.

U lus të paraqiteni në e-mail adresën time që e keni të botuar në krye të rubrikës sime në “Kosovare” dhe besoj se do të gjejmë zgjidhje të duhur për çdonjërin, qoftë me sugjerime, qoftë me ndihmë konkrete.

Pse vëllai ka ndryshuar?

Përhëndetje, ju shkruaj për vëllanë tim, me të cilin jemi në hall të madh. Ai disi na ka braktisur dhe na ka lënë të gjithëve për nusen e vet. Është martuar verës që shkoi dhe ajo i kërkoi vëllait ari, ashtu sikur e kanë zakon ana e tyre prej nga është ajo. Prindërit tanë kanë hyrë në borxhe për t’ia plotësuar dëshirat, por ajo nuk u mjaftua me kaq. Ajo nuk po e lë as vëllanë me ardhur te ne. Vëllai ka qenë shumë i afërt dhe shumë i dashur me të gjithë, por tani është bërë një egoist që nuk do të dijë fare për prindërit që vuajnë shumë për të. Ndryshimet e tij kaq të mëdha na bëjnë të dyshojmë se ai diçka nuk është në rregull, meqë ka filluar edhe të falet në xhami dhe në një bisedë na tha se po të mos e fillonte namazin dhe të besuarit në Zotin e madhërisëm, me siguri, do të vetëvritej.

Kjo gjendje po na brengos tepër, por edhe po kuptojmë se diçka nuk është në rregull me të.

Pse nusja nuk na do fare, e tash as vëllai?

“Pa shifër”

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Përgjigje:

Nuk ka diçka më të rëndë dhe më të shëmtuar se kur prindërit dhe familja nuk dinë se çka po ndodh me djalin apo bijën e tyre. Kjo tregon se vjen një nuse dhe ta shkatërron lumturinë dhe familjen, në vend që të sjellë lumturi, jetë e gjallëri. Në shpresë të kësaj lumturie prindërit bëjnë dasmë për martesën e të birit, duke menduar se ajo martesë do të sjellë të mira dhe rritje të shtëpisë, por kur ndodh e kundërta, bien komentet dhe hapen faqet e shëmtuara të tregimit. Unë shoh se ka shumë gjëra që nuk janë në rregull. Vëllai ua ka bërë me dije se kishte një depresion që e qoi kah besimi në Allahun xh. h. Për të mos bërë vetëvrasje Allahu xh. h. i erdhi në ndihmë. Namazi është njëri prej shtyllave të islamit dhe është obligim për çdo mysliman. Është për lakmi kur një person ndjek rregullat kuranore...

Unë nuk dua të zgjerohem shumë në këtë aspekt, sepse ka këtu çka të thuhet shumë. Por, faktet tregojnë se ai ka kaluar një krizë tepër të rëndë psikike për të arritur deri aty ku e ka gjetur shpëtimin.

Çka tutje?

Ai duhet t’i kthehet familjes dhe t’i njoh e t’i dojë prindërit dhe familjarët. Nuk mundet dikush të jetë mysliman i mirë e të mos e do nënën e babanë, të mos i do motrat dhe vëllezërit.

Nuk mund të jetë mysliman i mirë, e as njeri i mirë, nëse një person e distancon familjen e vet gjenetike. Shoh se ka shumëçka te ai që nuk është në rregull dhe u preferoj të paraqiteni në e-mailin tim të lartshënuar në rubrikë...



Contact- Reception - +38260008002
tel. +38269610003 +38269607865
hotel.continental.ulcinj@gmail.com
 /hotel_continental_ulcinj



Giardino
LUXURY APARTMENTS



+382 69 606 208

 /giardinolux



SHERWOOD

Resorts and Hotels



**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA